

FONDACIONI SHOQËRIA E HAPUR - MAQEDONIA

RAPORT VJETOR | 2015 |



Mars, 2016

REZYME E AKTIVITETEVE TË REALIUARA DERI NË FUND TË VITIT 2015

Fondacioni Shoqëri e Hapur – Maqedonia (FShHM), në suaza të strategjisë së vetë për periudhën 2014-2017, i drejton burimet dhe mundet e veta kah kthimi i demokracisë dhe qeverisja demokratike, si synim i vetë afatgjatë, nëpërmjet:

- Mbështetje e 12 organizatave qytetare për avancim të fushave vijuese të cilat janë identifikuar si më të cenuara: 1) liria e të shprehurit; 2) përparim i të drejtave të njeriut në shëndetësi; 3) angazhim i rinisë për ndryshime sociale; 4) luftë kundër korrupsionit; 5) monitorim dhe dokumentim i të drejtave të njeriut; dhe 6) transparencë e buxhetit. Këto organizata kanë ekspertizë relevante, qasje me grupe të përshtatshme të synimit, koalicione dhe baza të studentëve të mëparshëm të ndërtuara mirë, që ju mundëson të artikulojnë me efikasitet strategjitë e veta dhe t’ju përgjigjen sfidave dhe rrethanave të mundshme.
- Zbatim i katër koncepteve: Përforcim dhe mobilizim i qytetarëve; Komunë sipas masës të qytetarëve; Integrim i Romëve dhe Ndihmë humanitare dhe ligjore për migrantët.

MBËSHTETJE E FUSHAVE STRATEGJIKE

Arritje dhe/ose aktivitete kyçe të cilat e shënuan punën e organizatave të mbështetura në fushat strategjike të FShHM në vitin 2015

FUSHA 1:

LIRIA E TË SHPREHURIT

▪ MEDIE ONLAJN ▪

Katër medie informative onlajn (*A1on*, *Plusinfo*, *Portalb* dhe *Okno*) ju mundësuan qytetarëve informata nga ndodhi dhe tema aktuale të cilat mediet mejnstrim ose aspak nuk kanë qenë të trajtuara ose kanë qenë të marginalizuara, përkundër domethënies dhe fushëveprimit të tyre. Për ndikim e tyre dhe për rejtingun e tyre mes qytetarëve, si dhe për lexueshmërinë dhe audiencën e tyre, flasin të dhënat e marra nga YouTube, Google Analytics, GRID.MK ku vërehet rritje e konsiderueshme të numrit të shikuesve dhe lexuesve. Frekuentimi i Portalb-it u rrit nga 2.484.152 vizita në vitin 2013, në 9.786.367 në vitin 2015. Këtë e vërteton edhe anketa e Insitutit Republikan Amerika, sipas të cilës Portalb-i është ueb-portali më i lexuar shqiptar për lajme politike në Maqedoni. Krahasuar me periduhën e vitit të kaluar, në vitin 2015 është vërejtur rritje e madhe e vizitave dhe popularitetit të portalit *A1on*. Shprehur në numra, *A1on* në tetor të vitit 2014 ka pasur 456.033 vizita dhe 146.146 vizitorë individual, gjegjësisht, përdorues. Muajin e njëjtë në vitin 2015, numri i vizitorëve është gati se tri herë më i madh, gjegjësisht, 1.294.080 vizita dhe 425.008 vizitorë nga njësi individuale interneti. Sipas Google Analytics, *Plusinfo* ka regjistruar gjithsej 21.882.232 vizita (mesatarisht, 59.951 në ditë), 3.909.572 përdorues dhe 58.115.987 shikime (mesatarisht, 159.221 në ditë). Në vitin 2015, internet portali *Okno* mbeti i orientuar kah tekstet analitike, i hapur për temat rajonale, evropiane dhe botërore dhe mbeti në krye për përmbajtje kulturore. *Okno* nuk është faqe komerciale, por megjithatë, është e rëndësishme që vizitat e portalit nga formimi i tij janë gjithnjë duke u rritur, mes 20 dhe 30 për qind çdo vit.

▪ QENDRA PËR ZHVILLIM TË MEDIIVE ▪

Në vitin 2015, Qendra për zhvillim të mediave (QZhM) u përfshi aktivisht në bisedat për reformat e nevojshme në sferën e mediave, gjegjësisht, për ndryshimet e nevojshme në politikat e mediave dhe në legjislacionin lidhur me to që të mundet Maqedonia të ketë vërtetë një sistem të lirë, të hapur, demokratik dhe pluralistik të mediave.

Qendra për zhvillim të mediave në prill të vitit 2015 organizoi debatin “Çfarë sistem i mediave i nevojitet Maqedonisë”. Në këtë debat, ku u prezantua botimi “Ligjet në sferën e mediave: Sfidë për lirinë e mediave”, u hap tema për nevojën e reformimit apo ridizajnit të tërë sistemit të mediave në Maqedoni. Këtë nevojë më vonë e vërtetoi edhe komuniteti ndërkombëtar, i cili i vendoi reformat në sektorin e mediave në qendër të marrëveshjes për zgjidhje të krizës së zgjatur politike në vend. Në qershor të vitit 2015, QZhM organizoi edhe konferencë rajonale me temë “Mediet dhe interesi publik”, në të cilën morën pjesë anëtarë të komunitetit gazetaresk dhe akademik të vendeve të rajonit më të gjerë të Ballkanit Perëndimor, por edhe nga Hungaria. Pjesëmarrësit në konferencë folën për aspektet e interesit publik në mediet dhe rolin e mediave në mbrojtjen e interesit publik dhe interesave të qytetarëve.

Në suaza të aktiviteteve të veta për promovim të reformave të nevojshme në sistemin e mediave dhe legjislacionin për mediat në Maqedoni, QZhM përgatiti edhe një sërë dokumentesh për politikat publike: “Mediat informative në internet dhe legjislacioni për mediat në RM”, “Mediat në legjislacionin zgjedhor” dhe “Fushata për informim publik të Qeverisë dhe institucioneve shtetërore”. Në lidhje me ndjekjen e legjislacionit për mediat, QZhM përgatiti dhe publikoi 3 raporte tremujore nga monitorimi i rasteve gjyqësore për ofendim dhe shpifje dhe 3 raporte tremujore për punën e organeve rregullatore, Kuvendi, Ministria për shoqëri informatike dhe administratë dhe për Radio Televizionin e Maqedonisë.

Në suaza të aktiviteteve në fushën e profesionalizimit të mediave informative në internet, QZhM organizoi dy punëtori për përfaqësues të mediave informative në internet. Gjithashtu, pas mbarimit të programit për testim të vijave alternative të të ardhurave për mediat onlajn, që përfshiu 10 faqe informative të internetit nga tërë Maqedonia, QZhM i mblodhi rezultatet nga hulumtimi në botimin “Qëndrueshmëria e mediave në mjedisin digjital”. Botimi është dizajnuar për botuesit e mediave informative në internet dhe ka për detyrë t’ju ndihmojë në arritjen e qëndrueshmërisë më të madhe nëpërmjet ofrimit të metodave për gjenerim të të ardhurave të cilat janë treguar si, më pak a më shumë, të suksesshme në procesin e testimit.

▪ METAMORFOZIS – FONDACIONI PËR INTERNET DHE SHOQËRI ▪

Gjatë vitit 2015, Metamorfozis – Fondacioni Për Internet Dhe Shoqëri (Metamorfozis) vazhdoi të përforcojë infrastrukturën alternative për informim dhe mobilizim të qytetarëve në Maqedoni me përdorim të teknologjive të reja. Duke u nisur nga nevoja që të afirmohen dhe përdoren të drejtat themelore të njeriut për liri të të shprehurit dhe privatësi, Metamorfozis vazhdoi të zhvillojë sinergji mes palëve të ndryshme të interesuara për zhvillim të demokracisë në Maqedoni, duke i kombinuar resurset dhe mjetet e zhvilluara dhe mirëmbajtura në projektin “Internet i lirë dhe i hapur” dhe në projektet tjera të veta, si *Shërbimi për verifikim të fakteve në media*, *Vërtetmatës*, *Portalb* dhe agjencia e lajmeve *META*. Njëkohësisht, u zmadhua aktiviteti

për thyerje të izolimit ndërkombëtar informativ të Maqedonisë, veçanërisht lidhur me ngjarjet aktuale – kriza politike, protestat qytetare, ngjarjet në Kumanovë, Marrëveshja e Përzhinës dhe pasojat e saj. Në këtë kontekst, *Metamorfozis* arriti të mirëmbajë dhe të avancojë rrjetin e bashkëpunimit edhe me organizatat joqeveritare dhe mediat e pavarura në vend, e veçanërisht me rrjetet ndërkombëtare të dedikuara për lirinë e të shprehurit. *Metamorfozis* përdori një sërë metodash inovative për promovim onlajn me të cilat e zmadhoi dukshmërinë e luftës së organizatave joqeveritare dhe aktivistëve kundër korrupsionit politik, duke kontribuar për motivim të qytetarëve që t'i bashkëngjiten kësaj lufte me vetëdijesim për të drejtat e tyre në sferën digjitale, si dhe për detyrimet e autoriteteve, mediave dhe faktorëve të tjerë të cilët ndikojnë në cilësinë e jetës në Maqedoni.

Jashtë shtetit u rrit dukshmëria e ngjarjeve në Maqedoni me përdorim të rrjeteve ndërkombëtare të organizatave qytetare, medie dhe/ose aktivistë/blogerë, si element i rëndësishëm për mobilizim të mbështetjes nga komuniteti ndërkombëtar dhe kori diplomatik, institucionet dhe shoqatat ndërkombëtare. U realizua bashkëpunim aktiv direkt për çështjet e lidhura me lirinë e të shprehurit në Maqedoni me rrjetet e Reporterë pa kufij, EDRi - Të drejta digjitale evropiane, APC, IFEX, Global voices etj., si dhe OSBE-së dhe përfaqësuesit për lirinë e mediave në OSBE, UNDP dhe përfaqësive diplomatike në vend.

Për shkak të përfshirjes të të gjitha palëve të interesuara, këto përpjekje u kombinuan me trajnime dhe ngjarje publike të dedikuara rrjetëzimit, lobimit dhe përfaqësimit, mes të cilave ishin konferencat e organizuara nga *Metamorfozis*: e-Shoqëri.com “Liria dhe privatësia në internet” (dhjetor) dhe ditët ndërkombëtare të aksionit “Liri në vend të frikës” në Shkup (tetor), konferenca POINT në Sarajevë (mars) etj., ku morën pjesë qindra përfaqësues të shoqërisë civile dhe mediave, institucioneve shtetërore dhe arsimore dhe sektorit privat.

FUSHA 2:

AVANCIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT NË SHËNDETËSI

▪ KOALICIONI TË DREJTA SEKSUALE DHE SHËNDETËSORE PËR KOMUNITETET E MARGJINALIZUARA ▪

Gjatë vitit 2015, *Koalicioni Të Drejta Seksuale Dhe Shëndetësore Për Komunitetet E Margjinalizuara (Koalicioni DSShKM)* vazhdoi të punojë në drejtim të avancimit të gjendjes me të drejtat seksuale dhe shëndetësore të personave që u përkasin grupeve të marginalizuara shoqërore: komuniteti LGBTI; personat që përdorin drogë; personat që jetojnë me HIV dhe punëtorët e seksit. Si rezultat i angazhimeve afatgjata për përfshirje të mirëfilltë të institucioneve kompetente në punën me komunitetet e marginalizuara, në bashkëpunim me Institutin për Çështje Sociale u përgatit “Udhëzim për punë me komunitete/grupe të marginalizuara në rrezik”, i cili zyrtarisht u miratua nga Ministria e punës dhe politikës sociale. Udhëzimi, si MODUL 19, u bë pjesë e programit zyrtar për trajnim për zhvillim të vazhdueshëm të ekspertëve në sistemin e mbrojtjes sociale sipas të cilës u trajnuan 50 punëtorë socialë nga qytete të ndryshme. Është mbajtur seminar për të drejtat shëndetësore ku morën pjesë mjekë, anëtarë të komisioneve etike dhe komisione për kontroll të spitaleve të përgjithshme (Manastir, Tetovë, Shkup), spitali psikiatrik Shkup, IPSH SPQ “8 Shtatori” Shkup, si dhe përfaqësues nga Komisioni për mbrojtje të të drejtave të pacientëve në qytetin e Shkupit, Komisioni për

parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi dhe Avokati i Popullit i R. Maqedonisë. Në kontekst të debateve për të drejtat e njeriut, seminari ishte një mundësi që anëtarë të komisioneve shëndetësore, si dhe të organeve shtetërore për luftë kundër diskriminimit, për herë të parë të flasin për të drejtat shëndetësore të komuniteteve të marginalizuara.

Është përgatitur dhe botuar analiza “Përdorimi i drogave dhe jeta me HIV në arsim”, e cila përmban analiza nga ekspertë të teksteve shkollore nga arsimi i mesëm dhe i lartë në sferat e sociologjisë, pedagogjisë, etikës, ligjit penal, sigurisë, psikiatrisë dhe shkencave tjera të lidhura. Në analizën, për herë të parë bëhet rishikim i përmbajtjeve lidhur me trajtimin e përdoruesve të drogave dhe jetës me HIV.

Në suaza të mbrojtjes të të drejtave seksuale dhe shëndetësore të personave që u përkasin komuniteteve të marginalizuara, gjatë vitit 2015, *Koalicioni DSShKM* nisi disa procedura për personat transgjnorë: një kërkesë për njohje ligjore të gjinisë, kurse për tre raste dorëzoi ankesa në organ të apelit të shkallës së dytë, ku njëra prej ankesave është miratuar dhe rasti vazhdon para Prokurorisë themelore publike. Është nisur procedurë para Gjykatës Supreme për rishqyrtim të njërit nga rastet e shkeljes të të drejtave të personit që jeton me HIV. Është dhënë kërkesë në Prokurorinë themelore publike, Institutin për mjekësi ligjore, si dhe ndërhyrje tek Avokati i popullit për rrjedhën e hetimit të vdekjes së një personi gjatë shërbimit të dënimit me burg. Janë këshilluar dhe janë përgatitur dy parashtrës me shkrim dhe mbrojtje për dy klientë të akuzuar për përdorim të drogës.

Në pajtim me Ligjin e mediave, lidhur me lidhjen e statusit HIV me orientimit homoseksual, janë dërguar kërkesa për korrigjime deri në gjashtë medie. Të gjitha mediet e shpallën korrigjimin, përveç një medie e cila e fshiu lajmin nga ueb faqja e vetë. Janë dërguar 2 ankesa pas vendimeve të Prokurorisë publike për gjuhë të urrejtjes, ku Prokuroria e lartë publike e refuzoi njëren ankesë, kurse tjetrën e ktheu në shqyrtim në Prokurorinë themelore publike. Komisioni për ankesa i Këshillit për etikën në media të Maqedonisë e pranoi ankesën për gjuhë të urrejtjes në emisionin “Jadi burek”.

Janë realizuar më shumë aktivitete për përfaqësim ndërkombëtar të të drejtave të komuniteteve të marginalizuara: janë përgatitur raporte në hije për Komitetin për të drejta civile dhe politike dhe për Komitetin kundër torturës; në raportin për përparimin e vendit, deri në KE është dërguar paraqitje për gjendjen lidhur me çështjen LGBTI, në *Transgender Europe* është dërguar paraqitje me të dhëna të përditësuar për gjendjen e personave transgjnorë; e para Komitetit për të drejta të njeriut është prezantuar paraqitje me gojë për gjendjen e çështjeve LGBTI në Maqedoni, kurse në takim të mbyllur, ekspertët e Komitetit janë informuar për problemet e personave LGBTI.

Me qëllim që të avancohet dokumentimi i rasteve të shkeljes të të drejtave seksuale dhe shëndetësore të komuniteteve të marginalizuara, janë kryer 2 trajnime me aktivistë dhe pjesëtarë të grupeve në shënjestër në Manastir dhe Strumicë, janë trajnuar 10 persona të rinj, e në përgatitje është ueb-platforma për dokumentim të rasteve të dhunës kundër personave LGBTI.

Gjatë vitit 2015, *Koalicioni DSShKM* ishte aktiv edhe në plan të promovimit të aktivizmit për të drejtat e komuniteteve të marginalizuara. Është organizuar për herë të tretë *Java e krenarisë* e cila përfshinte disa ngjarje kulturore, ligjërata nga hulumtues nga rajoni, trajnime për aktivistë dhe tre fjalime protestuese të drejtuara kah: Prokuroria publike, Qeveria e RM dhe Radio Televizioni i Maqedonisë. Që të krijohen bërthama aktivistësh në vend, është mbajtur trajnim për aktivizëm kreativ për aktivist nga Tetova, Manastiri, Prilepi, Sveti Nikole dhe Shkupi.

▪ HOPS - OPSIONE PËR JETË TË SHËNDOSHË ▪

Në vitin 2015, në suaza të programit për *Opsione për jetë të shëndoshë Shkup (HOPS)* për sigurim të ndihmës juridike dhe sociale për punëtorët e seksit dhe përdoruesit e drogës dhe të programit për përfaqësim të të drejtave të personave të mitur përdorues të drogës, janë dhënë gjithsej 438 shërbime për 42 persona të cilët përdorin drogë (37 meshkuj dhe 5 femra) dhe 8 anëtarë të familjes të personave që përdorin drogë, prej të cilëve 4 janë këshilla për të drejtën e mjekimit. Është siguruar përfaqësim për klient rom i cili përdor drogë, kundër të cilit ka procedurë penale dhe i cili ka gjendje shëndetësore të përkeqësuar pasi pësoi goditje, ka vështirësi në të folurit dhe nuk ka mundësi të mbrojë veten në gjykatë. Është siguruar ndihmë e vazhdueshme juridike për punëtorët e seksit për shkeljen e shumë të drejtave të njeriut në bastisjes policore “Shtypje e prostitucionit në rrugë” e kryer nga MPB në nëntor të vitit 2008. Përveç kësaj, është kryer edhe përfaqësim ndërkombëtar nëpërmjet dërgimit të kërkesës për hetim për shkelje sistematike të të drejtave të punëtorëve të seksit para Komitetit për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave.

Gjatë vitit 2015 u realizuan më tepër aktivitete për aktualizim të çështjes së mungesës nga programi i përkatshëm për trajtim të personave të mitur që përdorin drogë. Është realizuar fushatë gjithëpërfshirëse për fëmijët të cilët përdorin drogë, janë prezantuar 5 video klipe dhe janë realizuar më shumë vizita në emisione të mëngjesit në disa televizione kombëtare. Fushatën e mbështetën 18 shoqata qytetare, kurse për konferencën përfundimtare të shtypit që u mbajt më 26 qershor u raportua në më tepër televizione kombëtare dhe media të tjera në gjuhën maqedonase dhe shqipe. Është kryer trajnim për 16 pjesëmarrës nga qendrat ndërkombëtare për punë sociale nga Shkupi, Velesi dhe Shtipi, përfaqësues nga institucionet arsimore sociale dhe shoqata të qytetarëve; janë mbajtur dy punëtori në qendrat ditore për fëmijët e rrugës, në Kisela Voda dhe Autokomandë; janë dhënë shërbime sociale për familjet me fëmijë që përdorin drogë; informata për dokumente personale, informata për realizim e të drejtës për mbrojtje sociale, informata për realizim të drejtës për kujdes shëndetësor etj. Është përpiluar protokoll për trajtim të fëmijëve që përdorin drogë. Është kryer ri regjistrim i metadonit, me çka ndërpritet kufizimi me moshë për përdorim të trajtimit me metadon.

Janë realizuar 15 vizita në rrugë, me qëllim të vetëdijesimit dhe informimit për të drejtat e tyre shëndetësore dhe të drejta për trajtim, janë kontaktuar 7 fëmijë të ri (6 meshkuj dhe 1 vajzë në moshë 16-17 vjeçare), kurse gjithsej 18 fëmijë të ndryshëm. Nga fëmijët e ri të kontaktuar, njëri injekton metadon, kurse tjerët thithin ngjitës.

Në plan të përfaqësimit ndërkombëtar, janë përgatitur më tepër raporte për organet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut për nivelin e gëzimit të drejtave shëndetësore në romëve përdorues të drogës, me përqendrim në fëmijët që përdorin drogë. Në përpilimin e raportit në

hije për gjendjen me fëmijët në Republikën e Maqedonisë, HOPS morri pjesë me të dhëna nga puna me fëmijë që përdorin drogë. Në maj, bashkë me organizata tjera partnere, dhanë raport në hije para Komitetit kundër torturës ku u adresuan pyetjet për problemin e romëve të cilët shpesh janë viktimë të dhunës policore dhe për mungesën e trajtimit për fëmijë që përdorin drogë. Në rekomandimet e veta për shtetin, Komiteti kundër torturës theksoi që duhet të parandalohet tejkalimi i kompetencave të policisë. Të gjitha akuzat për dhunë mbi romët duhet të dokumentohen dhe me kohë të hetohen, shqyrtohen, kurse autorët e krimit të dënohen.

Në qershor, para Komitetit për të drejta të njeriut, gjithashtu, u adresua çështja e problemit me fëmijë që marrin drogë dhe si rezultat i përfaqësimit, në korrik u shpallën perceptimet e Komitetit dhe rekomandimet për shtetin lidhur me avancimin e të drejtave të fëmijëve që përdorin drogë. Për këtë çështje u raportua edhe para Komitetit për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit gjinor, e me perceptimet dhe rekomandimet e veta për shtetin, Komiteti shprehi shqetësim për rritjen e regjistruar të fëmijëve të varur nga droga, veçanërisht romë, gjendja e të cilëve është përkeqësuar për shkak të varfërisë të prindërve të tyre dhe pengesat ligjore për qasje të fëmijëve më të vegjël se 18 vjet në mjekim të varësisë.

Në mbështetjen për përforcimin e punëtorëve të seksit për vetë-përfaqësim, janë formuar ekipe të para-ligjoreve, janë trajnuar 6 punëtorë të seksit nga Shkupi dhe nga dy para-ligjorë nga Gostivari, Ohri dhe Strumica. Para-ligjorët nga Shkupi nisën me punë nga maji dhe gjatë muajit maj dhe qershor janë realizuar takime me 35 punëtorë të seksit (29 femra dhe 7 femra transgjinore).

Si rezultat i aktiviteteve të përfaqësimit për sigurim të financimit të pandërprerë të shërbimeve për parandalim nga HIV pas mbarimit të mbështetjes nga Fondi global në vitin 2017, HOPS ka kryer një analizë të buxheteve të: Programit për mbrojtje të popullatës nga HIV/SIDA, Programit për mbrojtje të personave me sëmundje të varësisë dhe Programit për mbrojtje sociale. Në bashkëpunim me Platformën për HIV në RM, është mbajtur dëgjim publik në Kuvendin e RM ku u prezantuan gjetjet e monitorimit.

FUSHA 3:

ANGAZHIMI RINOR PËR NDRYSHIME SHOQËRORE

▪ FORUMI RINOR ARSIMOR ▪

Gjatë vitit mbi 1.000 të rinj morën pjesë në ndonjërin nga 48 klubeve rinore *Debate*, *Mësojmë drejtësi* dhe *MediArt* në 14 qytete nëpërmjet të cilave ndjekën ligjëratat të rregullta javore për argumentim, sundimin e ligjit, të drejta dhe liri qytetare dhe politike dhe aktivizëm kreativ. Anëtarët e këtyre klubeve organizuan mbi 30 ngjarje për bashkëmoshatarët dhe komunitetet e tyre: aksione vullnetare, debate publike, ekspozita dhe fushata informative. Në 12 komuna u kryen procese të ndërtimit të kapaciteteve tek organizatat rinore dhe të përfaqësimit për krijim të organeve përfaqësuese rinore, që rezultoi me themelimin të këshilleve lokale rinore në 11 komuna si organe këshilluese të cilat i përfaqësojnë interesat e të rinjve nga komuniteti. U krijuan edhe 8 strategji rinore lokale dhe plane aksionesh.

U organizua konferenca për aktivizëm shoqëror *ENGAGE* në të cilën mbi 400 aktivist të rinj morën pjesë në prezantime, diskutime dhe punëtori për aktivizëm. U mbajtën dy ngjarje *Argument: Shprehje e organizuar*, të cilat synojnë të mundësojnë debat cilësor në hapësirë publike. Ngjarja e shkurtit ishte në tezën “Kjo Shtëpi do të kishte shkuar nga Maqedonia përgjithmonë”, kurse ngjarja e dhjetorit, që ishte *Argumenti* më i vizituar deri më tani, në tezën “Kjo Shtëpi beson që negociatat mespartiake çojnë në dalje nga kriza”. Në debatet kishte mbi 700 mysafirë dhe 5.000 shikues onlajn dhe transmetoheshin në televizionin 24 Vesti. Falë përfaqësimit të organizimit për debat në shoqëri, vitin e njëjtë u bë edhe partner në NDI në zbatimin e dy sezoneve të TV-debateve me audiencë në studio për çështje të rëndësishme politike nën emrin *Otvoreno*.

Forumi rinor arsimor (MOF) ka kryer dhe botuar 3 hulumtime: „Studenti si bartës i ndryshimeve shoqërore“, „Mobiliteti i studentëve dhe kuadrit akademik nga Universiteti ‘Shën Kirili dhe Metodi’ “ dhe “Analizë ligjore e organizimit dhe pjesëmarrjes studentore në Maqedoni” dhe dërgoi 500 kërkesa për qasje në informata me karakter publik tek shkollat e mesme dhe komunat për vërtetim të gjendjeve të ekzistimit dhe rregullimit të komuniteteve të shkollave të mesme dhe këshillet lokale rinore.

Radio MOF mundësoi hapësirë për organizata dhe grupe rinore. Në Radio MOF kishte emisione për tema të cilave rrallë u përkushtohet vëmendje: të drejtat e nxënësve në shkollë të mesme, shëndet seksual dhe riprodhues, multikulturalizëm, kulturë alternative. Në radio transmetohen edhe emisioni i parë për të drejtat LGBTI në Maqedoni, *STR8 OUT*, si dhe emisioni i parë i kushtuar personave me Daun sindrom, udhëhequr nga një djalë i ri me Daun sindrom, *Jas sum Cako*. Gjatë vitit, ky medium ka mbi 1 milion vizita, 500.000 vizitues unikat, emisionet dëgjohen nga 2.000 njerëz në muaj, kurse ekipi i gazetarëve të rinj ka krijuar 5.000 publikime. Protestat e studentëve dhe shkollave të mesme u mbuluan gjerësisht nga Radio *MOF*, ku sigurohej edhe lajvbloging, panel diskutime, videostrime dhe vizita në emisione. Ekipi i *MOF*-it ofroi ndihmë para-ligjore, këshilla për përfaqësim dhe veprim dhe ndihmë teknike për nxënësit pjesëtarë të plenumit të shkollave të mesme dhe nxiti komunikim me Avokatin e popullit.

Kapacitete të 8 komuniteteve të shkollave të mesme u përforcuan me trajnime, punëtori, përgatitje të programeve dhe mbështetje në organizimin e ngjarjeve. Programi debativ i *MOF*-it organizoi 2 ngjarje kombëtare debative për 300 pjesëmarrës, prej të cilëve njëri ndërkombëtar me 80 pjesëmarrës nga tërë bota dhe më tepër rajonale. Debatueset nga MOF u klasifikuan në gjysmëfinalen në kampionatin botëror të debatit dhe fituan vendin e 3 dhe 4 si folëse në kategorinë Anglishtja si gjuhë e huaj.

FUSHA 4:

LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

▪ QENDRA MAQEDONASE PËR EDUKIM EVROPIAN ▪

Në vitin 2015, *Qendra Maqedonase Për Edukim Evropian (QMEE)* botoi më tepër botime dhe me këtë, konsiderueshëm e përforcoi komponentin hulumtues të organizatës. Disa prej tyre janë: „Cilësia e vendeve të punës të cilat i ofrojnë kompanitë e themeluara në ZZhit“, „Mundësi dhe kurthe në procesin e negociatave“, „Padi kushtetuese - drita në fund të tunelit“ etj. Në lidhje me

ndjekjen e procesit të aderimit të Maqedonisë në BE u përgatitën këto raporte: raporti i 24-të “Saga e përbashkët bujqësore” dhe raporti i 25-të “TIK-TAK TIK-TAK në një minutë para dymbëdhjetë”, si dhe analiza komparative e raporteve të KE për 2012–2015, „Kthim mbrapsht – nuk është premtuar, është bërë“. Përveç kësaj, u përgatitën edhe tre studime: “IPA studimi”, “Qeverisje e mirë - përvoja dhe sfida” dhe “Nga nënshtrimi deri në okupim - lëvizja studentore në Maqedoni në vitin 2014“. *QMEE* i përdori të gjitha studimet dhe dokumentet e kryera për politika publike për përfaqësim dhe përforcim të anës por evropiane të diskursit publik, por edhe në luftën e shumanshme për pranim të vlerave dhe standardeve evropiane. Kështu që, *QMEE* rregullisht merrte pjesë në konsultimet e Delegacionit të BE-së në Shkup gjatë krijimit të raportit të Komisionit evropian për Maqedoninë, ngjarjet e organizuara për konsultim nga Sekretariati për çështje evropiane dhe institucione dhe organizata tjera.

Instrument shumë i rëndësishëm ishin sesionet *EUROTALK* të cilat shërbyen për përforcim serioz të ndikimit të shoqërisë civile mbi aktorët politik dhe komunitetin ndërkombëtar gjatë zgjidhjes së krizës politike në vend. *QMEE*, gjithashtu, intensivisht punoi në vendosjen rajonale në aktivitetet e Këshillit për bashkëpunim rajonal nga Sarajeva dhe Konventës Rajonale për integrim evropian në Malin e Zi. Kështu që, përfaqësuesit e *QMEE* kanë marrë pjesë në mbi 10 konferenca rajonale me temë integrimi në BE dhe Ballkani Perëndimor dhe ndikimi i organizatave *think-tank* në këto procese.

QMEE ka kryer gati se 160 ditë trajnim dhe mentorim me lloj dhe kohëzgjatje të ndryshme dhe me to përfshiu gati se 300 persona (nga autoritete lokale, organizata qytetare, gazetarë, avokatë dhe studentë). Trajnimet mbulonin temat në vijim: Historia e BE-së, institucione dhe marrja e vendimeve, Programimi i fondeve të BE-së, Aplikimi në fondet e BE-së, Studimi i kornizës evropiane për të drejtat e njeriut, Demokracia, të drejtat e njeriut dhe sundimi i ligjit në BE, Krijimi dhe shkrimi për politikë publike, Përfaqësimi dhe monitorimi e të ngjashme.

FUSHA 5:

MONITORIMI DHE DOKUMENTIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT

▪ KOMITETI I HELSINKIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË RM ▪

Gjatë vitit 2015 ishte vërejtur shkelje masovike e të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë. Bisedat e përgjuara në mënyrë të paligjshme të publikuara nga opozita zbuluan korrupsion, shkelje të parimeve kushtetuese, si ndarje e pushtetit, sundim i ligjit dhe shtet ligjor. Pas publikimit të njërës prej incizimeve në 5 maj 2015, numër i madh i qytetarëve u mblodhën para Qeverisë së RM të shprehin pakënaqësinë e tyre për shkak të fshehjes të vrasjes të Martin Neshkovskit. Për shkak të dhunës së tepërt nga policia në këtë protestë, qytetarët vazhduan të protestojnë edhe ditët vijuese, deri më 17 maj 2015, kur u mbajt protesta e opozitës së bashkuar. Tërë këtë periudhë, *Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut në RM (Komiteti i Helsinkit)* ishte organizata e parë ku qytetarët paraqitnin shkeljen e të drejtave, kurse mediat vendase dhe të huaja (veçanërisht BBC, Al Xhezeira, televizionet kombëtare në Turqi dhe Kroaci, televizion privat francez) kërkonin informata, qëndrim dhe mendim juridik. Në këtë periudhë, *Komiteti i Helsinkit* bashkëpunonte edhe me përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, veçanërisht me Kombet e Bashkuara, *Human Rights Watch*, *Amnesty International*.

U sigurua ndihmë ligjore për 15 veta nga pjesëmarrësit në protestat e 5 majit, të cilët në *Komitetin e Helsinkit* paraqitën shkelje të të drejtave, kurse raporte për dhunë të tepërt nga ana e policisë u morën nga edhe 10 persona të cilët nuk donin të nisin asnjëfarë procedure kundër policisë për shkak të mosbesimit në sistem. Në pjesën e diskriminimit është siguruar ndihmë juridike në 14 raste të reja, prej të cilëve 5 raporte ishin për diskriminim në bazë të bindjes politike, 4 raste në bazë të përkatësisë etnike, 2 raste në bazë të aftësisë së kufizuar intelektuale, dhe 2 raste në bazë të orientimit seksual. Duke marrë parasysh punën strategjike të *Komitetit të Helsinkit* në pjesën e profilimit racor të romëve në kalimet kufitare, për 2 raste të tilla është siguruar edhe përfaqësim në gjykatë dhe procesi gjyqësor është në vazhdim e sipër.

Në vitin 2015 është parashtruar dhe pranuar 1 aplikim i ri në Gjykatën evropiane për të drejta të njeriut për rastin e personit të mitur - viktimë e trajtimit jonjerëzor dhe degradues nga ana e të punësuarve në IP Enti për mbrojtje dhe rehabilitim Banja Banjsko.

Sa i përket Rrjetit për mbrojtje nga diskriminimi, veçanërisht të rëndësishme ishin përgatitja dhe publikimi i raportit vjetor me të cilin u mundësua vazhdimësi në raportimin për gjendjen me diskriminimin dhe në dorëzimin e raportit në hije tek Komiteti për eliminim të diskriminimit racor. Përfaqësuesit e Komitetit të Helsinkit ishin aktiv edhe në Rrjetin kombëtar kundër dhunës mbi gruan dhe dhunë në familje, veçanërisht nëpërmjet sigurimit të këshillave juridike, për shkak të rritjes së rasteve të dhunës familjare.

FUSHA 6:

TRANSPARENCA E BUXHETIT

▪ ASOCIACIONI PËR EMANCIPIM, SOLIDARITET DHE BARAZI TË FEMRAVE NË MAQEDONI - ESE ▪

Gjatë vitit 2015, *Asociacioni për emancipim, solidaritet dhe barazi të femrave - ESE (ESE)*, nëpërmjet monitorimit dhe analizës së buxheteve, përgatiti pesë raporte për realizimin financiar dhe të programit për programet për mbrojtje shëndetësore preventive dhe kurative nga buxheti i Ministrisë së shëndetësisë për vitin 2015.

U dorëzuan gjashtë ankesa deri tek Komisioni për mbrojtje të së drejtës për qasje të lirë në informata me karakter publik për shkak të heshtjes së administratës publike edhe atë kundër Ministrisë së Shëndetësisë të RM dhe dy ankesa për të kundërshtuar vendimin për mos shpallje të të dhënave *NL Agency, division NL EVD International, ORIO*. Këto ankesa kanë të bëjnë me kërkesat për vazhdim të procedurës për analizë të zbatimit të projektit ORIO. Si shtesë, është publikuar dhe distribuuar analiza “Çka ndodh me të hollat nga granti holandez ORIO destinuar për avancim të mbrojtjes shëndetësore të nënave dhe fëmijëve”.

Në bazë të analizave, janë dërguar kërkesa me projekt-masa konkrete për avancim të transparencës reaktive dhe proaktive buxhetore të Qeverisë së RM, Ministrisë për shëndetësi dhe Ministrisë për financa në lidhje me përdorimin e fondeve nga buxheti i përgjithshëm, buxheti për aktivitete vetë-financuese, buxheti për donacione dhe buxheti për kredi, edhe atë: një kërkesë me katër projekt-masa për ministrin e financave; kërkesë me tetë projekt-masa për ministrin e shëndetësisë; dhe një kërkesë me tre projekt-masa për zëvendëskryeministrin e

Qeverisë së RM për çështje evropiane. Deri të gjitha këto institucione, përveç propozimeve individuale, është dërguar edhe propozimi i dërguar në Ministrinë e shëndetësisë dhe mostër nga analiza.

Si rezultat i pjesëmarrjes aktive në grupin e punës për ndjekje të zbatimit të Planit të aksionit për partneritet të hapur të qeverisë 2014-2016, është miratuar konstatimi i Qeverisë së RM (seanca 79, 15.6.2015) me të cilin Ministria e shëndetësisë detyrohet deri më 30 qershor 2015 të formojë grup të punës të përbërë nga të gjithë koordinatorët e programeve preventive dhe kurative të Ministrisë dhe të organizojë takim me ESE në të cilin do të definohej përmbajtja dhe frekuenca e publikimit të raporteve për zbatimin e programit dhe atë financiar të të gjitha programeve nën këtë Ministri.

Gjetjet dhe rekomandimet e analizës së zbatimit të programit dhe atë financiar të komponentit të programit për zbulim të hershëm të kancerit në qafën e mitrës (nga Programi për zbulim të hershëm të kancerit) u prezantuan në të gjitha rajonet të cilat i përfshijnë qendrat individuale për shëndet publik në RM dhe përfaqësues të tjerë të institucioneve publike, gjinekologë, ekspertë dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Projekt-masat janë dërguar tek ministri për shëndetësi, ministri për financa dhe Qeveria e RM, kurse është shfrytëzuar edhe shënimi i Ditës botërore të luftës kundër kancerit (4 shkurt 2015) për dërgim të informatës me gjetjet deri tek të gjitha mediat. Informata u shpall në 22 medie të shtypura dhe elektronike.

Në vazhdimësi është siguruar mbështetje teknike për organizatat partnere romë për planifikimin e aktiviteteve për llogaridhënie sociale për periudhën 2015–2016. Janë përgatitur strategji kombëtare dhe plane lokale të përbashkëta për përfaqësim në lidhje me çështjet për: imunizim të fëmijëve rom (prej 0 deri 15 vjet) për vitin 2015 dhe avancim i përfshirjes së romëve (prej 24 deri 60 vjet) me Programin për skringing të kancerit të qafës së mitrës. Është përgatitur analizë e shkurtër me gjetjet kyçe për Programin për mbrojtje aktive shëndetësore të nënave dhe fëmijëve dhe për Programin për kontrole sistematike, kurse me rast të Ditës botërore të romëve, në bashkëpunim me organizatat partnere romë, është mbajtur konferencë shtypi në të cilën janë prezantuar gjetjet kyçe të marra nëpërmjet monitorimit të komunitetit dhe monitorimit të buxheteve, e të cilat kanë të bëjnë me shëndetin e romëve. Gjetjet dhe rekomandimet u publikuan nga 9 medie të shtypura dhe elektronike, kurse ishin të promovuara edhe nëpërmjet rrjeteve sociale. Janë mbajtur debate publike për temat në vijim: “Shërbime preventive shëndetësore dhe imunizimi për fëmijët romë në R. e Maqedonisë” dhe “Avancim i përfshirjes së femrave me Programin për skringing të kancerit të qafës së mitrës”.

Për para-ligjorët nga tre organizatat romë, është siguruar mbështetje teknike nëpërmjet trajnimeve, përditësimit të vazhdueshëm dhe shtim të përmbajtjes në ueb faqen www.healthrights.mk; nëpërmjet ndryshimeve dhe shtimit të formularëve ekzistuese për punë dhe të bazës elektronike për mbledhjen e të dhënave; si dhe nëpërmjet kryerjes së monitorimit dhe vlerësimit të punës së para-ligjorëve dhe në përgjithësi, punës në programet për ndihmë para-ligjore. Është realizuar edhe një trajnim shtesë për përfaqësuesit nga organizatat partnere romë lidhur me mundësitë për përfaqësim të rasteve strategjike në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Është përgatitur plan për bashkim të dy komponentëve (llogaridhënie sociale dhe arsimim dhe përforcim juridik) me themelim të konceptit të ri të punës, duke përfshirë ndarje të re dhe hartim të komuniteteve romë dhe përdorim i konceptit të punës nëpërmjet animues dhe lehtësues nga vetë komuniteti rom.

Si mbështetje për shoqërinë civile të interesuar për analizë të buxheteve, është kryer trajnim treditör për monitorim dhe analizë të buxheteve dhe mjete tjera për përfshirje të komunitetit, janë trajnuar 19 përfaqësues të shoqatës civile, kurse janë përkthyer dhe publikuar edhe dy doracakë: “Rishikim detajor i procesit për buxhetim të bazuar në prioritetet” dhe “Hapje e qeverisë - Udhëzues për praktikën më të mirë të transparencës, përgjegjësisë dhe pjesëmarrjes qytetare në sektorin publik”.

Gjatë vitit 2015, ESE përgatiti edhe: raport të gjetjeve të procedurës për vlerësim të nivelit të transparencës proaktive të institucioneve publike; publikim i bazuar në gjetjet nga hulumtimi i kryer për kujdes të papaguar të personit të sëmurë rëndë; broshurë me rekomandime për avancim të kryerjes të programit për skring (zbulim i hershëm) i kancerit në qafën e mitrës; raport në hije për paktin ndërkombëtar për të drejta ekonomike, kulturore dhe sociale; raport për zbatim të strategjisë për mbrojtje nga dhuna familjare dhe video spot i shkurtër për promovim të rëndësisë nga kontrollet e rregullta gjinekologjike me PAP test. Është vënë edhe ueb faqe tematike për transparencë dhe llogaridhënie - Transparencë fiskale Maqedonia - për të cilën është vënë baner për promovim në më tepër portale dhe media të tjera.

KONCEPTE NË VITIN 2015

Avancim lidhur me synimet kyçe në vitin 2015

KONCEPTI 1:

PËRFORCIM DHE MOBILIZIM I QYTETARËVE

Synimi i konceptit për përforcim dhe mobilizim të qytetarëve është të kontribuojë për ri ngjalljen e qeverisjes demokratike.

Synimi i parë i konceptit është individë, grupe joformale dhe organizata qytetare të përforcuara, të koordinuara në platformë të hapur, inkluzive dhe jopartiake, t'i aktualizojnë çështjet akute dhe provokative si përgjigje për kthimin mbrapsht të demokracisë.

(1) Platforma për politika qytetare HAJDE! (HAJDE!), e cila u themelua në vitin 2014 nga 150 aktivistë, vazhdoi aktivisht të veprojë nëpërmjet aksioneve dhe performanseve qytetare, me qëllim që të alarmojë publikun për mosfunksionimin e institucioneve dhe rënien e vlerave demokratike. Kjo platformë edhe në vitin 2015 mbeti e vërejtur në publik me aksion kundër censurës së paraparë me propozim-ligjin për ndalim të shpalljes së materialeve të përgjuara, si dhe me kundërshtim të kufizim të qasjes në Qeverinë e RM me aksionin “Distancohemi nga Qeveria”.

(2) „Kultura dhe politika është program për trajnim e përpiluar nga FShHM me qëllim që të sigurojë njohuri më të gjera për përfaqësuesit e shoqërisë civile, grupeve joformale dhe aktivistëve në temat: art dhe fuqi, kultura e regjimit dhe kultura e rezistencës. U organizuan dy sesione në të cilët morën pjesë 56 pjesëmarrës.

(3) Që të mundësohet përgjigje qytetare për praktikat e rrënuara demokratike, u shpërndanë grante për 8 iniciativa aktivitetet e të cilave, mes tjerash, ishin përqendruar në mbrojtjen e të drejtës për protestë paqësore nëpërmjet sigurimit të ndihmës juridike, politika rinore dhe lokale, veçanërisht ato të orientuara kah përforcimi i marrëdhënieve ndëretnike dhe integrimi i personave me aftësi të kufizuara. Si shtesë, 13 aktivistë nga rrjetet sociale u mbështetën që të nxisin mendim kritik dhe debate në mediat e reja.

Në suaza të mbështetjes së koalicionit “Qytetarët për Maqedoninë” në të cilën marrin pjesë 75 shoqata civile, u krye aksioni “Meritojmë më mirë” që të informohen dhe të mobilizohen qytetarët për problemet e cekura në raportet e shumta vendase dhe ndërkombëtare të përpiluara si rezultat i krizës politike. Për këtë qëllim u mbështetën 17 organizata dhe aktivistë të shumtë të cilët morën pjesë në kryerjen e aktiviteteve në fusha të ndryshme (çështje rinore, drejtësi dhe liri, qeveri e ndershme, mjedisi jetësor, shëndetësi, arsim, standard i jetesës etj.). Nëpërmjet bisedave në teren me qytetarët dhe 20 intervenimet në hapësira publike, u distribuuan mbi 52.000 broshura, 12.000 fletëpalosje, 98.000 kopje të tre edicioneve të gazetës “Ja pse”. Nëpërmjet një sërë kanalesh dhe mjetesh komunikimi, aksioni ishte promovuar masovikisht në rrjetet sociale ku mbi 20.000 qytetarë dhanë mbështetjen e tyre, kurse radio dhe video spotet transmetoheshin në 7 rrjete lokale, 3 rajonale dhe 3 kombëtare.

(4) Gjatë vitit 2015, në mediat e shtypura dhe ato sociale u promovuan 7 ALARME të cilat mbulojnë tema nga fusha e ekonomisë dhe të drejtat e njeriut.

(5) Klubi i qytetarëve për Maqedoni evropiane (GEM klubi) vazhdoi të jetë alternativa e vetme në hapësirën publike të ngushtuar. Janë mbajtur gjithsej 225 ngjarje të organizuara nga *FShHM* dhe rreth shtatëdhjetë organizata, grupe joformale, iniciativa ose koalicione qytetare, kërkues të pavarur, ambasada dhe shtëpi botuese, në të cilat morën pjesë më shumë se 5.000 vizitues. Promovimet e publikimeve maqedonase të “Besnik deri në vdekje” nga Keith Brown, “Drejt origjinës së nacionalizmit shqiptar” nga Natalie Clayer dhe “Kujtime të jetës - Vëllimi II (912 - 1925)” nga Eqrem Bej Vlora, të shoqëruar me debate publike, si dhe ligjërata “ A ka nacionalizëm të dobët dhe a është kjo kategori e dobishme” me prof. Marija Todorova dhe debatet për ardhmërinë e Evropës dhe raportin e Qendrës për politika evropiane “Shtetet anëtare të BE-së dhe zgjerimi në Ballkan”, të organizuara nga *FShHM*, janë ngjarje që shkaktuan interes të madh tek publiku.

Gjatë vitit 2015, në suaza të Projektit të USAID për shoqëri civile, të cilin *FShHM* e kryen nga viti 2012, me konkurse publike u dhanë 41 grante për shoqëri civile. Grantet e dhëna janë nga tre komponentët e projektit: 14 grante për shoqëri civile të cilat veprojnë si bërthama demokratike në komunitetet e veta, 13 grante për shoqëri civile të cilat kryejnë mbikëqyrje të autoriteteve dhe përfaqësim të bazuar në hulumtime dhe 14 grante për aksione të përbashkëta të shoqërive civile. Projektet kryhen në periudhë prej 10 deri 18 muaj (deri në fund të muajit korrik 2016).

Për përmirësim të kapaciteteve për zbatim të granteve, u organizuan 4 trajnime hyrëse (procedura për zbatim të projekteve, raporte financiare dhe narrative, brendim i materialeve dhe ngjarjeve publike, komunikim dhe koordinim) si dhe 20 trajnime për: monitorim dhe vlerësim të projekteve, planifikim strategjik, vullnetarizëm dhe menaxhim i vullnetarizmit, aktivizëm qytetarë, komunikim me publikun dhe qasje e lirë në informata me karakter publik. Për

përforcim të kapaciteteve të organizatave qytetare për mbikëqyrje dhe përfaqësim, u organizuan trajnime për: programim dhe aplikim në fondet e BE-së, sundimi i ligjit, demokraci dhe të drejta të njeriut, ndjekje e harxhimit të të hollave publike, transparencë buxhetore dhe llogaridhënie. Me trajnimet u përfshijnë gjithsej 558 pjesëmarrës. Përfaqësuesit e grantistëve morën pjesë në 5 takime për rrjetëzim (Kriva Pallankë, Tetovë, Manastir dhe Shkup) dhe në *hackathon* social për përgatitje dhe zbatim të fushatave. Në forumin e *Platformës për politikë qytetare Hajde!* morën pjesë 56 anëtarë të platformës.

Në suaza të aktiviteteve për përfaqësim, e në bashkëpunim me partnerët dhe grantistët e projektit, u organizuan gjashtë debate publike, edhe atë: “Pjesëmarrja e qytetarëve në Maqedoni nga viti 2012 deri në vitin 2014: Përvoja dhe sfida”, debat dhe promovim i analizës komparative për pjesëmarrje të qytetarëve 2012-2014 (me *Reaktor - Hulumtim në aksion*); “Doracak për qytetari aktive”, promovim dhe debat (me Forum - Qendër për hulumtime strategjike dhe dokumentim), “Engage” - konferencë për aktivizëm shoqëror dhe dy ngjarje publike të debatit: “Argument - Shprehje e organizuar” (me *Forum in rinor arsimor*) dhe “A ka dalje nga padalshmëria!” (me *Qendrën maqedonase për arsim evropian*). Organizata partnere *Forum in rinor arsimor (MOF)* zbatoi akademinë e katërt rinore të verës me 80 pjesëmarrës, si dhe 12 trajnime të dedikuara për 163 të rinj, 6 aksione vullnetarësh me 170 pjesëmarrës (Manastir, Veles, Dibër, Kërçovë, Negotinë dhe Shkup), iniciativë lokale në Resnje dhe në Shkup, fushatë kombëtare rinore për argumentimin dhe debatin kompetitiv, ligjërata ekspertësh, *hackathon* studentor, turne kombëtare e debatit për fillestarë, me 114 persona të rinj, turne debati për ekipe të përziera, me 50 pjesëmarrës. *MOF* nisi me klube të debatit në dy universitete, përpiloi 5 video të shkurtra të animuara edukative për rolin dhe të drejtat e studentëve ngjarja promovuese e të cilave u vizitua nga 60 njerëz dhe e promovoi analizën për organizimin studentor dhe pjesëmarrjen në Maqedoni.

Organizata partnere *Forum - Qendra për hulumtime strategjike* dhe dokumentim në suaza të Shkollës për qytetari aktive përfshiu 51 pjesëmarrës nga gjenerata e 7-të dhe e 8-të, organizoi dy punëtori refleksive për gjeneratën e 6-të dhe 7-të, me 35 pjesëmarrës dhe takim të studentëve të mëparshëm të Shkollës, me 30 pjesëmarrës, kurse zbatoi edhe dy aksione të studentëve të mëparshëm. *Reaktor - hulumtim në aksion* publikoi dokument për politikë publike me rishikim të rezultateve të hulumtimit për aktivizmin qytetar nga viti 2012 deri në vitin 2014 dhe ka kryer hulumtimin për pjesëmarrje qytetare për vitin 2015. Organizata partnere *Qendra për komunikime qytetare* publikoi 5 raporte periodike nga monitorimi i prokurimeve publike të institucioneve në nivel kombëtar dhe lokal dhe 2 indekse të racionalitetit. Në bashkëpunim me *Qendrën maqedonase për arsim evropian* u shpallën 3 raporte nga monitorimi i aderimit në BE dhe analizë komparative e raporteve të Komisionit evropian për përparimin e RM për periudhën 2012-2015.

Synimi i dytë i konceptit është përforcimi dhe mobilizimi i qytetarëve për zhvillim të ligjeve dhe politikave alternative në mënyrë pjesëmarrëse, të cilat do të tregojnë përfitimet nga përfshirja qytetare dhe do të mobilizojnë aktorët e shoqërisë civile për ndërmarrje të aksioneve dhe veprim të zmadhuar për çështjet e interesit publik.

(1) Në suaza të këtij synimi u përfunduan ligjet alternative (për mbrojtje sociale dhe për referendum dhe iniciativë qytetare), të nisura në vitin 2014. Rekomandimi alternativ për Ligjin për mbrojtje sociale parasheh vënie të të ardhurave minimale që nuk është nën pragun e

varfërisë (p.sh.: 12.000 den. për familje), derisa tek Ligji për referendum, risi është definimi i çështjeve për referendum, roli i KShZ-së në procesin, rolet e bordeve këshillore për referendume. FShHM i nisi përgatitjet e analizave të cilat do të kenë për qëllim të kontribuojnë për përmirësim të praktikave të caktuara, para së gjithash, lidhur me kapitullin 23 të aderimit në BE, i cili përqendrohet në të drejtat e njeriut dhe drejtësi. Tema e parë hulumtuese do të hulumtojë definimin e interesit publik në legjislacion, kurse e dyta, zbatim i vendimeve të Gjykatës evropiane për të drejta të njeriut.

Në suaza të zbatimit të **Programit rajonal për promovim të hulumtimit (PRPH)**, në shkurt të vitit 2015 në Shkup u mbajt punëtorja rajonale me temë “Dizajn hulumtues i dokumenteve për politika publike - ndërtim i bazës për ndikim në politikat publike”, ku morën pjesë 24 hulumtues të rinj. Më 26 maj në Shkup u organizua tryezë e rrumbullakët me temë “Maqedonia 2015: Mes tundimeve autoritare dhe evropianizimit?”. Në ngjarje morën pjesë 69 pjesëmarrës mes të cilëve edhe hulumtues, përfaqësues të komunitetit akademik, organizatave joqeveritare dhe mediave. Në fund të majit, në Ohër u organizua konferenca ndërkombëtare vjetore e PRPH, “Ndryshime shoqërore, politike dhe ekonomike në Ballkanin Perëndimor” në të cilën morën pjesë 108 hulumtues. Në periudhën tetor-nëntor, me sukses u përfunduan tre projekte rajonale të mbështetura nga PRPH. Tre projektet tjera do të përfundojnë në vitin 2016. Në dhjetor filloi zbatimi i fazës së dytë të projektit “Dialog kombëtar për avancim të politikave në fushën e shkencave shoqërore në Maqedoni”. Synimi kryesor i këtij projekti është të rekomandohet model i ri financiar për mbështetje të projekteve hulumtuese nëpërmjet të cilave do të avancohet cilësia, efikasiteti dhe ndikimi i aktiviteteve hulumtuese në Maqedoni.

KONCEPT 2:

KOMUNË SIPAS MASËS TË QYTETARËVE

Koncepti parasheh krijim të modelit të komunës sipas masës së qytetarëve në të cilën zbatohet krijimi pjesëmarrës i politikave lokale dhe ofrohen shërbime cilësore për qytetarët. Aktivitetet në suaza të konceptit janë zbatuar në tre komuna të mëdha urbane: Strumicë, Qendër dhe Strugë. Në fillim të vitit 2015, me kryetarët e këtyre komunave u nënshkruan marrëveshje për bashkëpunim në suaza të këtij koncepti si vazhdim i aktiviteteve të realizuara në vitin 2014. Kah fundi i vitit 2015 u krye edhe vlerësim i jashtëm për aktivitetet në suaza të konceptit.

Synimi i parë i konceptit është drejtuar kah krijimi pjesëmarrës i politikave lokale, ku u realizuan diskutime publike dhe mundësi për pjesëmarrje të qytetarëve në miratimin e planeve të aksioneve për strategjitë lokale të zbatuara nga 4 fusha: arsim, të rinjtë, mbrojtje sociale dhe bashkëpunim me shoqërinë civile, si dhe sërë aktiviteteve për përforsim të kapaciteteve të administratës, përfaqësuesve të sektorit civil dhe shkollave.

(1) Gjithsej 244 pjesëmarrës nga të punësuarit në komuna, anëtarët e këshilleve, të punësuar të shkollat lokale dhe përfaqësues të shoqërisë civile në tre komunat morën pjesë në trajnime të shënjestruara për: drejtësi kundër-diskriminuese dhe sociale, bashkëpunim ndërsektorial, të drejtat dhe inkluzionin e fëmijëve, monitorim i prokurimeve publike në nivel lokal dhe zhvillim i aplikacioneve për fonde në dispozicion nga programet e BE-së. Gjetjet e vlerësimit të jashtëm të konceptit treguan që trajnimet (në përgjithësi, por edhe çdonjëra veçmas) kanë kontribuar për përforsim të kapaciteteve të administratës së komunës, por edhe të përfaqësuesve të këshilleve të komunës. Si përfitim shumë i rëndësishëm nga trajnimet ceket përforsimi i kohezisë mes

personelit të komunës. Trajnimet kanë mundësuar të krijohen dhe/ose të funksionojnë kanalet e komunikimit mes personelit të punësuar më parë dhe personelit të punësuar në moment. Efekti i kohezisë nuk u planifikua, por gjatë vlerësimit është krijuar nga pjesëmarrësit në disa raste. Gjithashtu, të tre komunat i vlerësojnë trajnimet si mundësi për punë në ekip, shkëmbim të informatave, por edhe planifikim i përbashkët, pasi që takime të tilla nuk ka ose shumë rrallë organizohen nga vetë komunat. Me zbatim të punëtorive me përbërje të përzier, të përbëra nga administrata dhe shoqata civile për fondet e BE-së, u hap mundësi për iniciativa dhe projekte të përbashkëta mes administratës të komunës dhe shoqërisë civile për aplikim në fondet e BE-së.

Përfaqësuesit e anketuar nga shkollat kanë treguar për një përqindje të lartë të dobisë nga trajnimet e kryera prej të cilave më së shumti janë përdorur njohuritë e fituara nga trajnimi për të drejtat dhe inkluzionin e fëmijëve. E njëjta u vërtetua edhe nëpërmjet gjetjeve nga fokus grupet të cilat tregojnë që trajnimet kanë kontribuar për përfundim të kapaciteteve individuale të përfaqësuesve në shkollat e përfshira. Njohuritë e fituara më së shumti do të përdoren për punën e rregullt.

Trajnimet për planifikim strategjik dhe pjesëmarrje u mbështetën edhe në praktikë pasi që pjesëmarrësit kishin mundësi të marrin pjesë në procesin e planifikimi dhe zhvillimit të planeve të aksioneve për strategjitë e miratuara lokale, ku në vitin 2015 janë mbajtur 12 diskutime publike, me pjesëmarrje të 387 qytetarëve në tre komunat, për finalizim të planeve të aksioneve për të rinjtë, arsim, mbrojtje sociale dhe bashkëpunim me sektorin joqeveritar.

(2) Në tremujorin e fundit të vitit janë zhvilluar 6 forum projekte, me pjesëmarrjen e 522 qytetarë (në komunën Qendër 166 qytetarë, në komunën Strugë 130 qytetarë dhe në komunën Strumicë 228 qytetarë), për zgjedhjen e aktiviteteve të planeve të veprimit për ko-financim nga FShHM dhe komunat. Si rezultat i përcaktimit të prioriteteve nga pjesëmarrësit e këtyre forumeve, janë dhënë 4 grante për ko-financim me komunat (dy në komunën Qendër nga strategjia për arsim dhe mbrojtje sociale, dhe nga një në Strugë nga strategjia për mbrojtje sociale dhe Strumicë nga strategjia për të rinjtë). Për zbatimin e një pjese të aktiviteteve të parashikuar me planet zhvillimore, shkollat kanë aplikuar me propozim-projekte dhe janë dhënë 3 grante për ko-financim të aktiviteteve. Përveç kësaj, para fundit të vitit 2015 janë zhvilluar 6 forume buxhetore, me pjesëmarrjen e 480 qytetarëve në tre komunat (në komunën Qendër 122 qytetarë, në komunën Strugë 167 qytetarë dhe në komunën Strumicë 191 qytetarë), për planifikim pjesëmarrës në programe prioritare të buxheteve komunale.

Qëllimi i dytë në kuadër të konceptit është në drejtim të mundësimit të serviseve cilësore për qytetarët dhe përfundimi i shoqërisë qytetare për pjesëmarrje aktive në jetën e komunitetit. Ky qëllim ishte arritur me anë të kombinimit të disa veçave dhe qasjeve.

(1) Në tre komunat, me anë të qendrave ishte mundësuar që 129 qytetarë të marrin ndihmë të drejtpërdrejtë administrative. Përveç kësaj, për tejkalimin e paqartësive të qytetarëve në lidhje me çështjet administrative, janë përgatitur dhe shtypur 2 manuale për kompetencat, procedurat dhe kushtet në komunën e Strugës dhe në komunën Qendër, si dhe një fletë informacioni për shërbimet në fushën e urbanizmit në komunën Strumicë. Në 23 trajnime në tema të ndryshme të zbatuar nga ana e qendrave të komunitetit kanë marrë pjesë 646 pjesëmarrës të sektorit qytetar, por edhe nxënës dhe mësime të tjerë.

Një prej praktikave të mira të nxitura nga komunitetet e tre komunave është realizimi i a. q. ditë të hapura të komunës, me çfarë, janë adresuar dy dimensionet e punës së vetëqeverisjes lokale.

E para ka të bëjë me themelimin e komunikimit të drejtpërdrejtë mes këshilltarëve dhe përfaqësuesve të administratës komunale dhe qytetarët. Komunikimi ishte zhvilluar në tema të ndryshme të interesit të qytetarëve, dhe janë zbatuar me anë të mbështetjes së qendrave. Inovacioni përbëhet në faktin që këshilltarët shfaqen si anëtarë të komisioneve të Këshillit, dhe deri më tani, ky lloj i bashkëveprimit (në lidhje me formatin, por edhe në lidhje me temat) nuk është organizuar nga ana e komunës. Përfitimi është në atë që diskutimi zhvillohet në relacion këshilltarë-qytetarë, si formë e drejtpërdrejtë e përgjegjshmërisë dhe transparencës. Dimensioni i dytë dhe përfitimi nga kjo praktikë ka të bëjë me adresimin e një sfide sistemore i pranishëm në gjitha komunat e shtetit, që është marginalizimi i rolit të këshillit të komunës, në krahasim me rolin dhe ndikimin e kryetarit të komunës. Mobilizimi i këshilltarëve të këshillave me anë të komisioneve në ditët e hapura ka kontribuar për përforcimin dhe plotësimin e obligimeve ligjore, edhe atë, në: sjelljen e politikave lokale dhe buxheteve; mbikëqyrje te kryetarit të komunës dhe administratës komunale; si dhe përfaqësimi i kërkesave të qytetarëve që i kanë votuar. Sipas zbulimeve të vlerësimit të zbatuar për zbatimin e konceptit, përfitimi nga ditët e hapura si praktikë përbëhet në rritjen e përgjegjshmërisë dhe transparencës së kryetarit ndaj këshillit, si dhe komuna ndaj qytetarëve. Gjatë vitit 2015 janë realizuar 16 ditë të hapura me përfaqësues të komisioneve pranë këshillave të komunave dhe me të punësuar në administratë në të cilën kanë marrë pjesë 361 qytetarë me mundësi të diskutojnë për çështje dhe tema të interesit dhe nevojave të tyre.

Qendrat e komunitetit në tre komunat janë përfshirë në mbështetjen e procesit të përpilimit të kartelave sociale që do të ndihmojnë për planifikim më të strukturuar të aktiviteteve dhe implikimeve financiare në periudhën vijuese, me anë të strategjisë dhe planit të veprimit për mbrojtje sociale. Janë zbatuar edhe disa kërkime të rëndësishme dhe debate publike, si për shembull, për migracionin e të rinjve të Strugës, vullnetarizmi dhe nevoja për profile të reja arsimore në Strumicë, ose ndryshime të PDU në komunën Qendër. Në Strugë është zbatuar një kërkim dhe është krijuar një bazë më të dhëna për kompani që mundësojnë kryerjen e praktikës në nivel lokal.

Qendrat e komuniteteve ishin aktive edhe në mbështetjen e disa iniciativave qytetare si “E duam QTQ” dhe referendumin për shpëtim të QTQ në komunën Qendër, “AJDE!”, u kyçën në parashtrësën grupore në Gjykatën Kushtetuese për kontestimin e Ligjit për Honorarë (janë mbledhur 521 në komunat e Strumicës, Strugës dhe Qendrës), QK Strumicë ka mbështetur iniciativën për aktivizimin e sërish të regjistrimit të studentëve të rinj në institutin për Studime Gjinore në Shkup, etj.

(2) Përkushtimi i FShHM për përmirësim të qasjes në drejtësi në Maqedoni, me fokus të grupeve të varfërve dhe marginalizuar, në kuadër të projektit **Qasje në drejtësi në Maqedoni**, i financuar nga Bashkimi Evropian (Instrumenti Evropian për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut), realizohet me mbështetjen e 6 organizatave qytetare për ndihmë falas juridike që kanë siguruar këshilla juridike dhe ndihmë juridike për 815 qytetarë. Prej 28 aplikimeve për ndihmë falas juridike të parashtruar tek Ministria e Drejtësisë, 14 presin aprovim, për 11 raste është siguruar një avokat në mbulim nga shteti, 2 raste janë tërhequr ndërsa 1 ishte refuzuar. Për të siguruar përfaqësim strategjik për 3 raste që ishin refuzuar, në sajë të projekti ishin siguruar avokat dhe ankesë individuale. Raporti për monitorim të zbatimit të ndihmës falas juridike ishte përgatitur dhe prezantuar në konferencën përfundimtare të projektit, dhe ishte shpërndarë tek gjitha instancat relevante. Strategjia për përfaqësim e synuar për përmirësim të Ligjit për Ndihmë Juridike Falas ishte zhvilluar për të vazhduar përpjekjet për qasje të barabartë në

drejtësi për qytetarët dhe të përforcohen kapacitetet e organizatave qytetare që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut.

KONCEPTI 3: **INTEGRIMI I ROMËVE**

Dedikuar për uljen e dallimit mes politikave dhe praktikave, si parakusht për integrim të romëve, ky koncept ka për qëllim të arrijë:

- Përforcim të romëve për realizimin të drejtave të tyre shëndetësore dhe për përmirësimin e arritjeve të tyre arsimore, dhe
- Kërkim të llogaridhënies nga Qeveria për zhvillimin, buxhetimi dhe furnizimin e sistemeve efektive dhe të drejta për arsim dhe shëndetësi.

Qëllimet afatgjata janë mirëmbajtja e integritit të romëve lartë në agjendën kombëtare edhe pas vitit 2015 dhe përsheptim të avancimit në lidhje me plotësimin dhe qëllimet dhe detyrat në fshatë shëndetësisë dhe arsimit nga Strategjia e re kombëtare për romët. Në kuptim të avancimit të punës së përbashkët dhe partneritetit me Programin për Shëndetësi Publike të *Fondacioneve të Shoqërive të Hapura (FSHH)*, 13 organizata qytetare romë dhe jo-romë ishin me rëndësi qendrore për arritjen e qëllimeve kryesore të vendosura për vitin 2015.

(1) Përforcim të romëve për realizimin të drejtave të tyre shëndetësore

- *Sigurimi i mbrojtjes juridike dhe ndihmës para-juridike për realizimin e të drejtave shëndetësore*

Numri i madh i kërkesave për ndihmë para-juridike gjatë viteve të fundit ka treguar për atë që popullata romë ende përballohet me probleme themelore të ekzistencës dhe pamundësi për të realizuar të drejtat që i takojnë, andaj janë të nevojshme përpjekje afatgjate për të arritur një ndryshim të dukshëm. Megjithatë, përvojat e punës së deritanishme tregojnë që përparimi në këtë proces (përveç njohurive, shkathtësive dhe udhëheqjes cilësore të procesit të përfaqësimit) varet edhe nga kyçja jo-drejtëpërdrejtë aktive e komunitetit në fjalë në procesin si faktor kryesor për ndryshim. Andaj, edhe në vitin 2015, *FSHH* ka vazhduar me mbështetjen e organizatave romë të qasjeve për përforcim juridik dhe shkrim/lexim juridik të komunitetit rom. Me anë të vizitave në teren dhe angazhimit të para-juristëve, është siguruar ndihmë para-juridike për më tepër se 1.3000 persona të lagjeve romë në Shuto Orizarë, Dellçevë, Pehçevë, Vinicë dhe f. Cernik, ndërsa për 313 persona në Delçevë, Pehçevë dhe f. Cernik, Pehçevë dhe Vinicë janë siguruar kontrollime mjekësore falas për tuberkulozë dhe kontrolle gjinekologjike. Puna e programeve të para-juristëve në komunitetet romë është promovuar me anë të shpërndarjes së 1.000 fletushkave dhe 900 kartela promovimi, që ka kontribuar që 744 amvisëri të informohen dhe të njoftohen me punën e programeve për ndihmë para-juridike. Përveç kësaj, janë zbatuar gjithsej 21 takime edukative, në të cilat kanë marrë pjesë gjithsej 372 persona, në temat: realizimi i të drejtës për kujdes nga tjerë, roli i inspektoratit sanitar, realizimi i të drejtës për ndihmë urgjente/të shpejtë, procedura dhe hapa për sigurimin e dokumenteve për identifikim personal për persona që nuk janë shtetas të RM, të drejta dhe obligime të përdoruesve të ndihmës sociale dhe transferime dhe ndryshimet nënligjore dhe plotësimet në këtë fushë,

ndryshime dhe plotësime të Ligjit për Sigurim Shëndetësor dhe realizimi i të drejtave nga gusha e mbrojtjes shëndetësore. Si rezultat i rritjes së vetëdijes dhe njohurive të përfituara për komunitetin, është avancuar edhe shkalla e bashkëpunimit dhe koordinimit me aktorët relevant lokal, janë organizuar gjithsej 43 takime me përfaqësues të FSS, shtëpitë shëndetësore, komunitat, komisionet për të drejtat e pacientëve, Qendrën për Punë Sociale, inspektoratin sanitar, etj. Në kohën e njëjtë, qytetarët rom gjithnjë e më shumë kërkojnë realizimin e të drejtave nga institucionet kompetente. Ashtu, për shembull, është iniciuar procedurë për përcaktimin e pasojave shëndetësore nga uji i ndotur për pije në f. Cernik, me të cilën me urdhër nga Agjencia për Ushqim dhe Veterinë, vetëqeverisja lokale ishte detyruar të zgjedh problemin.

Si rezultat i përfaqësimit juridik para gjyqeve të RM-së, janë miratuar: 3 vendime pozitive për shkelje të të drejtave shëndetësore me të cilat përcaktohen praktikat e gabuar, në instancën e parë (udhëzime për shërbim me metodë sipas zgjedhjes personale dhe përcaktim i gabimit të mjekut); vendim i plotfuqishëm me të cilën për herë të parë në gjyqësorin tonë është gjykuar për një qira me të holla për invaliditet të pësuar për shkak të gabimit mjekësor; vendim i plotfuqishëm për kompensim në të holla për dëm jo-material për shkak të shkeljes së të drejtave personale për shëndet shpirtëror të dy prindërve të fëmijës që ka pësuar invaliditet për shkak të gabimit mjekësor; iniciuar padi për kompensim që për herë të parë nga bazat është edhe shkelja e të drejtave për informim për gjendjen shëndetësore, ndërsa në procedurë do të zbatohet praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; janë përfunduar me sukses 3 raste të Gjykatës Administrative të RM për rregullimin e gjendjes së statusit/qytetare.

Një përfaqësim i mirë organizuar dhe i bashkuar, që ka përfshirë zbatimin e disa qasjeve në kohën e njëjtë (përfaqësim juridik dhe mediatik në bazë të dëshmimeve), ka rezultuar me miratimin e plotësimeve të Ligjit për Sigurim Shëndetësor me të cilën 20.000 të siguruar (për të cilat nga FSSM ishin paraqitur padi penale) ishin të liruar nga ndjekja penale. Ndonëse fillimisht e planifikuar për popullatën romë, iniciativa e përbashkët dhe e koordinuar për mbrojtje shëndetësore, e nisur nga koalicioni joformal prej 12 organizatave qytetare dhe 4 avokatë, në fund ka përfshirë gjithë të siguruarit përkatës, pa dallim nga përkatësia etnike. Si rezultat i monitorimit të vazhduar dhe përfaqësimit, nga viti 2015 personat e papunë dhe personat me të ardhura të ulëta nuk kanë më obligim të bëjnë regjistrim të serishëm të sigurimit shëndetësor sepse atë e zbaton FSSM me detyrë zyrtare, ndërsa të siguruarit informohen për vazhdimin e të drejtës me anë të vendimit të dërguar në adresën e shtëpisë.

- *Llogaridhënia për realizimin e shërbimeve shëndetësore që ndikojnë në statusin shëndetësor të komunitetit rom*

Përdorimi strategjik i qasjeve dhe veglave të ndryshme për llogaridhënie sociale ka kontribuar për përforcim të kapaciteteve të organizatave partnere romë për përfaqësim të llogaridhënies dhe transparencës në financimin dhe furnizimin e shërbimeve shëndetësore. Në vitin 2015, si rezultat i zbatimit të monitorimit të vazhdueshëm të komunitetit, është arritur një përfshirje e imunizimit të plotë të rregullt të 90% të fëmijëve nga moshat 0-15 vjeç në Delçevë, Cernik dhe Vinicë. Përqindja e lartë e përfshirjes me imunizim ka të bëjë me aktivitetet e përforcuara për përfaqësim dhe kyçje të përfaqësuesve nga institucionet publike shëndetësore (motrat në teren dhe mediatorët shëndetësor rom) në zbatimin e 2 aksioneve masive (shtator 2014 dhe prill 2015) me të cilën është bërë kontroll i kartelave për vaksinim të gjithë fëmijëve të moshës 0-15. Punëtoritë e rregullta arsimore për përfaqësuesit e komunitetit, radio emisionet tematike si dhe vizitat në teren nga përfaqësuesit e organizatave qytetare, kanë kontribuar në rritjen e vetëdijes

dhe njohurive për shërbimet shëndetësore të cilat institucionet janë të detyruar të furnizojnë. Ashtu, në kërkesë të komunitetit, është rritur numri i vizitave në teren në vitin e parë të lindjes së fëmijëve, prej 3 në 5 deri 7 vizita. Njohja me të drejtën e kontrollit gjinekologjik falas ka kontribuar që femrat romë të vijnë 297 kontrolle për skringing të hershëm të kancerit të mitrës. Përveç kësaj, përfshirja aktive e komunitetit rom ka nxitur aksione të përbashkëta me institucionet në nivelin lokal me të cilën nga komunat Delçevë, Vinicë dhe Pehçevë është siguruar pjesëmarrje financiare për aktivitete gjatë javës së imunizimit. Në komunën Shuto Orizarë, si rezultat i aktiviteteve të anëtarëve të komunitetit rom, është siguruar një automjet për në teren dhe është rritur numri i vizitave në teren, dhe me anë të përmirësimit të kushteve higjienike në pjesën e vaksinimit dhe kontrolleve të fëmijëve në ambulanten në Shuto Orizarë, janë siguruar kushte për imunizim të sigurt. Në debatin e mbajtur “Shërbime shëndetësore parandaluese dhe imunizimi i fëmijëve rom në R. e Maqedonisë”, përfaqësuesit e komunitetit rom, të përgatitur dhe të mbështetur me argumente, kanë përcjellë kërkesat e tyre për përmirësim të qasjes në imunizim dhe të shërbimeve shëndetësore parandaluese tek vendimmarrësit të pranishëm në debatin. Në takim me ministrin e shëndetësisë, përfaqësues të organizatave qytetare romë, që punojnë në përmirësimin e llogaridhënies së institucioneve të shëndetit publik, kanë prezantuar të dhënat dhe kanë përcaktuar pengesat me të cilat përballohen komunitetet romë në qasjen në shërbime nga Programi për Kontrolle Sistematike të Studentëve dhe Nxënësve dhe Programi për Mbrojtje Aktive Shëndetësore të Nënave dhe Fëmijëve. Në takim ishte marrë vesh për rekomandimet konkrete të dorëzohen tek kabineti i ministrit për të marrë parasysh gjatë përgatitjes së programeve për vitet vijuese. Përveç kësaj, pas takimit, ministri i shëndetësisë në dy raste ka paralajmëruar fillimin e organizimit të skringing të karcinomit të gjirit, dhe pastaj ka filluar edhe fushatë mediatike për promovim të skringing të karcinomit të grykës së mitrës të organizuar (vetëm në MTV 1 dhe MTV 2).

Sugjerimet e organizatave të cilat në vitet e fundit kanë ndjekur mbulimin e imunizimit të fëmijët romë dhe përfaqësimin e tyre për nevojën për masa shtesë për rritje të mbulimit të tyre me vaksinim, rezultoi me njoftim të Ministrisë së Shëndetësisë për të futur vakcina polivalente sipas kalendarit të rregullt për vaksinim. Kjo duhet ndikon në rritje të mbulimit të përgjithshëm të fëmijëve me vaksinim dhe është veçanërisht e rëndësishme për fëmijët romë, grupin më të rrezikuar të fëmijëve, pasi që me një ardhje dhe një administrim të vaksinës, fëmija do të imunizohet për më shumë sëmundje.

U përdorën vegla mediatike për përforsim të përfaqësimit për përmirësim të shërbimeve shëndetësore për romët, Në ditën botërore për luftë kundër karcinomit (4 shkurt 2015), deri tek të gjitha mediet është dorëzuar informata për rezultatet e monitorimit të Programit për zbulim të hershëm të sëmundjeve maligne (komponenti karcinom i grykës së mitrës dhe karcinom i gjirit). Informata është publikuar në 22 medie të shtypura dhe elektronike. Në Ditën botërore të romëve (7 prill) është mbajtur konferencë për shtyp ku janë prezantuar rezultatet kyçe të fituara nëpërmjet monitorimit të bashkësisë dhe monitorimit të buxheteve, që kanë të bëjnë me shëndetin e femrës dhe shëndetin e romëve. Rezultatet dhe rekomandimet janë publikuar në 9 medime të shtypura dhe elektronike, si dhe në rrjetet sociale. Veç kësaj, u mbajtën edhe dy debate publike: “Shërbimet shëndetësore parandaluese dhe imunizimi i fëmijëve rom në R. e Maqedonisë” dhe “Avancim i përfshirjes së femrave me Programin për skringing të karcinomit të qafës së mitrës”. Është përgatitur një video e shkurtër për promovim të rëndësishme të kontrolleve gjinekologjike me PAP test, informim për të drejtat nga Programi i Ministrisë së shëndetësisë dhe prezantim i rezultateve kyçe të marra me zbatim të

metodologjive për llogaridhënie sociale. Janë realizuar edhe paraqitje në emisione tematike televizive në TV Shutel, TV Telma dhe TV NOVA.

- *Zbatim i integruar i qasjeve për llogaridhënie sociale dhe ndihmë parajuridike për avancimin e shëndetit riprodhues*

Me qëllim që të përmirësohet shëndeti riprodhues i grave rome, u zhvilluar edukimi për të drejta riprodhuese nëpërmjet aktiviteteve në teren të përfaqësuesve të trajnuar nga bashkësia rome e komunës së Shuto Orizari për 573 rome (93 shtatzëne dhe 480 gra në periudhën riprodhuese). Është siguruar ndihmë juridike për 37 raste të shkeljes së të drejtave riprodhuese dhe këshillim juridik për 193 raste. Është realizuar kartela e tretë me nota nga bashkësia për cilësi dhe qasje ndaj shërbimeve shëndetësore të lidhura me shëndetin riprodhues. Në sesionin e 114-të të Komisionit për të drejta të njeriut ku u shqyrtua raporti i 3-të periodik i RM-së ndaj konventës ndërkombëtare për të drejta qytetare dhe politike, u parashtrua pyetja për mungesën e ordinancës gjinekologjike në Shuto Orizari. Si rezultat i përfaqësimit të disa partner organizatave rome, është ndërprerë praktika e pagesës së paligjshme të shërbimeve gjinekologjike në 5 ordianca private gjinekologjike, dhe janë siguruar shërbimet për gratë e Shuto Orizari tre herë në javë.

- *Ndryshimi i narativëve të deritanishëm ndaj romëve në institucionet qeveritare*

Përsikaj arritjeve të zbatimit shumëvjeçar të projekteve për avancim të të drejtave shëndetësore dhe qasjes të romëve deri tek shërbimet shëndetësore, përvojat nga terreni dhe rezultatet e hulumtimeve tregojnë se qëndrimet dhe sjelljet e punëtorëve mjekësor ndaj romëve në institucionet publike të shëndetit nuk kanë ndryshuar. Stereotipat dhe paragjykimet mbizotërojnë dhe përcaktojnë mënyrën e sjelljes ndaj pacientëve rom. Por nga ana tjetër, edhe romët kanë këndvështrimin dhe paragjykimet e tyre për punëtorët shëndetësor dhe mënyra në të cilën në përgjithësi ju drejtohen për shërbime shëndetësore.

Kështu që, në vitin 2015, FShHM vazhdoi me përkrahjen për aktivitetet e drejtuara kah ndryshimi i narativëve negativ ndaj romëve në institucionet shëndetësore. Janë nisur pilot projekte ku grupe të synuara janë punëtorët shëndetësor nga institucionet shëndetësore në: Shkup, Kumanovë, Prilep, Tetovë, Gostivar dhe Dellçevë, dhe banorët e bashkësive rome në këto qytete. Aktivitetet e projekteve përfshijnë intervenime të ndryshme të drejtuara kah ndryshimi i narativëve, siç janë: forum teatri, strip mesazhet, ngjarjet e përbashkëta ku punëtorët shëndetësor kanë mundësi që prej së afërmi të njoftohen me mënyrën e të jetuarit dhe traditat e romëve, përsëritje e hulumtimit themelor për qëndrimet në rajonin e Prilepit dhe Manastirit, etj.. Njëkohësisht, janë zhvilluar aktivitete për sigurim të qëndrueshmërisë së intervenimeve për ndryshim të narativëve ndaj romëve nëpërmjet paraqitjes së përmbajtjeve të posaçme arsimore për mosdiskriminim dhe punë me grupe të rrezikuara në programet mësimore të studimeve deridiplomike në shkollat dhe fakultetet mjekësore.

(2) Përmirësim në shkallën e nxënësve romë me shkollë fillore të përfunduar dhe rritje e numrit të nxënësve romë në shkolla të mesme si dhe studentë romë.

Gjatë vitit akademik 2014/2015, Romaversitas vazhdoi me përkrahjen e arsimit joformal për studentët romë, duke siguruar trajnime për 42 studentë në tema të ndryshme në interes të tyre (portfolio e karrierës; gjuha e urrejtjes; shkrimi akademik dhe përdorimi efektiv i kompjuterëve për nevoja të shkrimit akademik), të dizajnuar dhe realizuar nga studentë me më shumë

përvojë. Pesëmbëdhjetë nxënës të shkollave të mesme, përdorues të *Romaversitas*, gjithashtu fituan njohuri të reja për *Mësojmë drejtësi* nëpërmjet 10 grupeve të aktiviteteve, kurse 14 nxënës të shkollave të mesme i përforcuan shkathtësitë e tyre debutuese në 8 sesione.

Në mes të vitit 2015, *Romaversitas* kaloi prej projekt i FShHM në shoqatë të qytetarëve, të nisur dhe drejtuar nga vet studentët bursist të mëparshëm dhe përdorues të *Romaversitas*, që siguroi përkrahje nga Fondi rom për arsim dhe u bë pjesë e rrjetit ndërkombëtar të *Romaversitas*. Me këtë u siguroa realizimi i suksesshëm i idesë për strategji dalësi për ndërprerje të financimit të mëtutjeshëm të *Romaversitas* si pjesë e FShHM.

Si pjesë e angazhimit për arsim inkluziv, *FShHM* realizoi trajnim disaditësh në temën “Si të realizojmë arsim inkluziv cilësor” për 4 mësime nga 4 shkolla fillore. Pas përfundimit të trajnimit, FShHM ju dha mundësi këtyre shkollave që të zbatojnë atë që kanë mësuar dhe të përmirësojnë politikën dhe praktikën inkluzive. Janë siguruar grante për 4 iniciativa të vogla shkollore për përmirësim të qasjes në shkolla për nxënës me pengesa në zhvillimin fizik, rritje të pjesëmarrjes dhe përmirësim i bashkëpunimit me prindër, zbulim i nevojave të ndryshme të nxënësve për ndihmë shtesë në përvetësimin e programeve mësimore, si dhe përmirësim të suksesit të nxënësve rom. Në bashkëpunim me Fakultetin e pedagogjisë në Ljubljana, FShHM përgatiti dhe promovoi publikimin për pjesëmarrje të nxënësve në shkollat ku janë vendosur 4 aksione hulumtuese të zbatuara nga projektet e shkollave fillore në Kumanovë. Qëllimi ishte të përforcohet shkrimi leximi hulumtues i mësimeve nëpërmjet zbatimit të aksioneve hulumtuese për përmirësim të punës së mësimeve dhe shkollave.

Programi për bursa për studentë rom (RMUSP) dhe Programi për bursa mjekësore për romët (RHSP) kanë dhënë kontribut të madh për rritjen e numrit të nxënësve të shkollave të mesme dhe studentëve rom të diplomuar në vend. Për vitin akademik 2015/16, janë dhënë 114 bursa (60 djem dhe 54 vajza) nëpërmjet programit RMUSP dhe 23 bursa (18 vajza dhe 5 djem) nëpërmjet programit RHSP (2 janë nxënës të shkollave të mesme dhe 21 janë studentë në mjekësi); 100 bursistë të RMUSP dhe RHSP kanë diplomuar, kurse 44 prej tyre janë të punësuar (pjesa më e madhe në administratën publike, pjesë në shëndetësi dhe pjesa tjetër në sektorin qytetar); 56 nxënës të shkollave të mesme, bursist të RHSP programit kanë përfunduar shkollën e mesme mjekësore me përkrahjen të Programit, kurse 23 studentë rom i përfunduan studimet e mjekësisë, dhe një pjesë e tyre janë në specializime në fusha të ndryshme. RHSP bursistët kanë pasur ndihmë mentori prej 14 mësimeve, morën pjesë në kampin veror dhe në trajnimet për përfaqësim, dhe gjithashtu kishin mundësinë që të marrin pjesë në 4 projekte të vogla hulumtuese, së bashku me mentorët e tyre, në tema të ndërlidhura me shëndetin e romëve. Nëpërmjet komponentëve shtesë të programit RHSP, tre nga bursistët fituan grante të vogla shtesë për pjesëmarrje në ngjarje akademike, kurse 2 bursist fituan grante për mësim të gjuhës së huaj.

(3) Sigurim i hulumtimeve dhe rekomandimeve për përfaqësim të informuar

Me qëllim që të siguron përfaqësim të informuar të partner organizatave romë dhe jo-romë për llogaridhënie nga shteti mbi realizimin e shërbimeve arsimore dhe shëndetësore të romëve, FShHM promovoi rezultatet dhe rekomandimet nga analizat dhe hulumtimet e zhvilluara: 1) mendimi publik “A kanë sot romët arsim më të mirë?”; 2) Analizë e segregacionit të romëve në arsimin e RM dhe 3) Strategjitë kombëtare të romëve në RM: analizë e aspekteve arsimore.

U realizuan dy trajnime për 16 aktivist të organizatave qytetare romë që punojnë në fushën e arsimit dhe të drejtave shëndetësore të romëve; e para për përpilim të dokumenteve të shkurta për politika publike dhe e dyta për mbledhje dhe analiza të të dhënave. Trajnimet rezultuan me 5 dokumente të shkurta për politika publike (policy briefs), të përpiluara me përkrahje të mentorëve, në tema prej këtyre dy fushave, me rekomandime për tejkalim/përmirësim. Dokumentet janë në dispozicion të publikut edhe në publikim elektronike “Aktivistët romë për politika të informuara dhe efikase për integrim të romëve”.

FShHM dorëzoi parashtesë tek Kombet e bashkuara për gjendjen pas Konventës kundër diskriminimit racor, ku theksoi edhe problemet me të cilat ballafaqohen nxënësit rom në arsim. *FShHM*, është gjithashtu pjesë e iniciativës së 5 organizatave qytetare, *Qendra evropiane për të drejta të romëve* dhe *Komiteti i Helsinkut për të drejta të njeriut në RM* për nisje të procedurës gjyqësore *actio popularis* për segregacion të nxënësve rom në shkollat për nxënës me nevoja të posaçme dhe në paralelet speciale për fëmijë me nevoja të posaçme në shkollat e rregullta.

(4) Është krijuar rrjeti joformal rom për përfaqësim që të mundëson përfaqësim efektiv dhe pjesëmarrje të romëve

FShHM dhe partner organizatat i prezantuan ministrin pa resor në Qeverinë e RM, përgjegjës për zbatimin e Dekadës për përfshirje të romëve, rezultatet dhe rekomandimet nga parashtesa për përmirësim të politikave dhe masave për arsim dhe mbrojtje shëndetësore në Strategjinë e re kombëtare për romët. Përfaqësues të *FShHM* morën pjesë në takimin e 7 për romë dhe romë refugjat, si dhe në diskutimin për raportin e BE-së mbi progresin e RM për vitin 2015 sa i përket të drejtave të romëve, organizuar nga qeveria maqedonase. U ndërmorën edhe një sërë aktivitete tjera përfaqësuese dhe pjesëmarrje në një seri të takimeve të punës, konferencave dhe punëtorive me faktor kombëtar dhe ndërkombëtar, si pjesë e proceseve për konsultim në përpilimin e Strategjisë kombëtare, ku u dhanë edhe rekomandimet tona për përmbajtjen e planeve të ardhshme kombëtare për aksion.

❖ E drejta e arsimit

Me qëllim që të informon strategjinë e vet dhe më lehtë të përcakton prioritetet e ardhshme strategjike dhe intervenimet në arsim, *FShHM*, në bashkëpunim me Programin për arsim të *Fondacionit Shoqëri e hapur* nga Londra, përsëri realizoi hulumtim të mendimit publik për reformat arsimore në mostër reprezentative të prindërve dhe studentëve, si dhe grupit të kontrollit të mësimdhënësve dhe nxënësve të shkollave të mesme.

Qëllimi i këtij hulumtimi ishte të kontrollon mendimin e aktorëve të ndryshëm për reformat në arsim në 10 vitet e fundit dhe efektet e tyre, për trendët e lidhura me pjesëmarrjen e tyre në dizajnimin e reformave dhe zbatimit të tyre, për mundësinë e ndikimit mbi to, si dhe mendimin e organizimit të nxënësve të shkollave të mesme dhe mësimdhënësve. U zhvillua edhe analiza e përmbajtjes dhe diskursit që promovojnë programet arsimore dhe tetë librat nga grupi humanistik i lëndëve në arsimin fillor nga aspekti i drejtësisë sociale, respektimin e dallimeve. Të drejtave të njeriut të të gjitha anëtarëve të shoqërisë dhe respektimin e vlerave universale. Njëkohësisht u përpilua edhe një shqyrtim me analizë të shkurtër të intervenimeve në fushën e arsimit inkluziv në Republikën e Maqedonisë, me rekomandime për aktivitete të mëtutjeshme.

Në të njëjtën kohë, *FShHM* përkrahi projektin e *FRA* (MOF) – Angazhimi rinor – që merret me hulumtimin e cilësisë së arsimit të mesëm, nëpërmjet informimit të rritur të të rinjve nëpërmjet videove dhe përpilimin e përmbajtjeve multimediale të Radio MOF në më shumë gjuhë, si dhe nëpërmjet rritjen e shkrim leximit mediatic tek nxënësit e shkollave të mesme.

KONCEPT 4:

NDIHMJA HUMANITARE DHE LIGJORE PËR EMIGRANTËT

Qëllimi i konceptit është përmirësimi i mbrojtjes së të drejtave dhe shërbimeve që i marrin emigrantët dhe kërkuesit e azilit derisa kalojnë nëpër Maqedoni, në bashkëpunim me organizatat partnere *Legis – Shkup, Komiteti i Helsinkut për të drejta të njeriut në Republikën e Maqedonisë* (KHM) dhe *Shoqata maqedonase e juristëve të rinj* (ShMJR).

Qëllimi i parë i konceptit është përmirësimi i politikave dhe praktikave momentale publike nëpërmjet debateve publike, dokumenteve për politika publike dhe ndërtimin e kapaciteteve.

FShHM dhe partner organizatat, *KHM, Legis dhe ShMJR*, janë të pranishëm me aktivistët e tyre dhe personelin në kampet për transit në kufirin verior dhe jugor, me leje për hyrje të siguruara nga institucionet kompetente. Rreth 250.000 pako me ushqim dhe gati se numër të njëjtë të rrobave janë dorëzuar në të dy kalimet kufitare nga *Legis*. *KHM* formoi dhe trajnoi katër ekipe (2 të vazhdueshme mobile, 1 mobil prej zyre dhe 1 në zyrë) që ndjekin punën e zyrtarëve policor dhe qasjen ndaj të drejtave për viktimat e dhunës ose shkeljeve tjera të të drejtave të njeriut në të dy kalimet kufitare. Janë dokumentuar: 24 incidente kundër refugjatëve, në tab të posaçëm të www.zlostorstvaodomraza.mk; 5 denoncime tek MPB nga ana e vëzhguesve që kanë qenë në kontakt me refugjatët viktimë. Veç kësaj, *MKHM* shpall raporte javore prej tereni. Janë dorëzuar 2 parashtresa për zyrtar policor që kanë keqpërdorur autorizimin ose kanë përdorur fuqi të tepërt ose joproporcionale. *ShMJR* zhvilloi trajnim hyrës për rreth 30 avokat dhe jurist mbi aspektet ligjësore të përfaqësimit dhe sigurimit të të drejtës ligjore për kërkuesit e azilit.

Në shtator të vitit 2015, *FShHM* zhvilloi trajnim rajonal për aktivistë dhe përfaqësues të organizatave lokale qytetare, me të cilën mundësoi edukim në fushën e “Dokumentimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut në kushte të luftës” në fazë të hershme, për më shumë se 30 aktivistë dhe përfaqësues të organizatave nga Maqedonia, Serbia, Kroacia, Greqia dhe Hungaria. Përskaaj njohurive të fituara, pjesëmarrësit kishin mundësinë të zhvillojnë bashkëpunime dhe komunikim në tërë shtrirjen e rutës ballkanike, e cila vazhdon të jetë aktive, dhe të kontribuojnë për shkëmbimin e informatave të sakta dhe në kohë, pavarësisht prej kufijve të shteteve.

Veç kësaj, *FShHM* mundësoi që aktivistët lokal, përfaqësues të partner organizatave dhe të tjerë të marrin pjesëmarrje aktive në takime rajonale dhe ndërkombëtare për shkëmbim të informatave, rrjetëzim dhe zbatim të aksioneve me organizatat përkatëse, lëvizje formale dhe joformale, me çfarë u mundësua komunikimi i papenguar mbi kufitar, koordinimi dhe bashkëpunimi. *Legis, KHM, FShHM dhe ShMJR* kontribuojnë në shkëmbimin e informatave dhe ideve të grupeve lokale në rrjetet sociale, sikur *Help the Refugees* – rrjet joformal i organizatave lokale dhe ndërkombëtare që punojnë në teren, nëpërmjet takimeve mujore ose urgjente sipas nevojave në teren nëpërmjet Google rrjetit Migrants2015, dhe në më shumë rrjete rajonale dhe evropiane sikur: *Balkan Route* (komunikim i mbrojtur nëpërmjet postës elektronike), rrjeti

joformal evropian *SolidarityBeyondBorders* me platformën e vet të mbrojtur me veglën Slack.com ku ka mbi 100 aktivistë që njoftojnë dhe shkëmbejnë informata për gjendjet në 20 shtete, përfshirë Turqinë.

Me nisjen e punës në kampet për transit kampet, *FShHM* lehtëson dhe nxit bashkëpunim me institucione shtetërore dhe ndërkombëtare, organizata dhe organe. Për këtë arsye, *FShHM* dhe partner organizatat nënshkruan Memorandum për bashkëpunim me Ministrinë e punës dhe politikës sociale, në procedurë është nënshkrimi i memorandumit me ndërmarrjen publike Hekurudhat e Maqedonisë Transport SHA – Shkup dhe memorandum me ekipet ndërkufitare të organizatës ndërkombëtare *Mjek pa kufi* në Serbi dhe Greqi, që të mbledhin pohime mbi shkelje të të drejtave të njeriut për personat që kanë kaluar nëpër Maqedoni dhe kanë qenë viktime të dhunës. Partner organizatat *ShMJR* dhe *KHM* kanë nënshkruar edhe Memorandum për bashkëpunim me Ministrinë e punëve të brendshme, me çfarë ju është mundësuar edhe qasje në institucionet e mbyllura si departamenti për paraburgim për hyrje të parregullt të të huajve në Gazi Babë.

Sa i përket përmirësimit të politikave dhe praktikave momentale publike, *FShHM* ka zhvilluar dy debate publike, dhe ka dhënë kontribut në dy aksione të aktivistëve para zyrave të Delegacionit të Komisionit evropian në Shkup. Paraqitjet publike të *FShHM* dhe partner organizatave janë në drejtim të kontributit individual dhe të përbashkët për bartjen e mesazheve, problemeve dhe nevojave të refugjatëve dhe emigrantëve që kalojnë nëpër Maqedoni ose ballafaqohen me probleme në rajon dhe tërë Evropën. Deri tani, partnerët janë drejtuar bashkërisht në dy konferenca shtypi, edhe atë me apel për Hekurudha të Maqedonisë Transport SHA – Shkup për politika diskriminuese në transportin publik për refugjatët dhe me dorëzimin publik tek Qeveria dhe tek Delegacioni i Komisionit Evropian në Shkup, në Ditën ndërkombëtare të të drejtave të emigrantëve dhe anëtarëve të familjeve të tyre, kur me protestë dhe aksion u shënuar 18 dhjetori i vitit 2015. Me paraqitjet individuale/tematike në publik, sipas fushës që mbulojnë, partner organizatat mundësojnë informata për qytetarët që institucionet nuk i shpallin ose dezinformojnë publikun.

FShHM ka përgatitur raporte të rregullta javore që ia ka dorëzuar rrjetit të *Fondacioneve Shoqëri e hapur*.

Qëllimi i dytë i konceptit është realizimi i kampanjës publike kundër ksenofobisë, e zhvilluar në më shumë nivele, që përfshin medie, informata të bazuara në internet, aksione sociale në nivel lokal dhe partneritetet të themeluar me medie dhe gazetarë.

Në suaza të qëllimit të dytë, janë zhvilluar aktivitete përgatitëse për zbatim të trajnimeve lokale të gazetarëve me ekspert të vendit dhe të huaj nga fusha e anti-ksenofobisë, raportimit etik dhe moral gjatë krizës humanitare nëpërmjet përdorimit të shprehjeve ligjore dhe shprehjeve tjera, me qëllim që të respektohet postulati themelor gjatë punës ose raportimit për kriza humanitare: Mos shkakto dëm!

Shuma e përgjithshme e mjeteve të shpenzuara për zbatimin e aktiviteteve të FShHM në vitin 2015 është 310.130.413 denarë, prej të cilave 209.998.890 denarë janë mjete të Fondacioneve Shoqëri e hapur, kurse 100.131.523 denarë tjerë janë nga donatorë tjerë.